



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.202 dt.24.12.1998

**MBI  
AKORDIM FONDESH PER MEREMETIMIN E  
KULLES SE SAHATIT(MONUMENT KULTURE).**

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Seksionit të Kulturës “Mbi akordim fondesh për meremetimin e Kullës së Sahatit(Monument Kulture)”, në mbështetje të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, neni.34, pika.13, dhe pika.21,

**VENDOSI**

1. Të akordojë fondin prej 600.000 lekë për veshjen e Kupolës dhe meremetime të tjera të objektit Muze Sahati i Tiranës.
2. Ky fond do ti kalojë Drejtorisë së Muzeve të Tiranës e cila do të realizojë mbrojtjen e këtij objekti nëpërmjet grupit të specialistëve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Muzeve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**